



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1626/2 Prot.

Tiranë, më 27 / 11 / 2018

V E N D I M

Nr. 240, Datë 27 / 11 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 175, datë 13.11.2018, të paraqitur nga S.Z kundër Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga S.Z, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash deklaroi se, që në vitin 1992 nga Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastrër ka marrë me qira një pronë shtetërore për të ushtruar aktivitet tregtar. Që nga viti 1997 e në vijim ka filluar përpjekjet për privatizimin e objektit, por pa rezultat. Subjekti ankues në periudhën Maj 2018, me anë të një shkrese i është drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit për rishikimin e procedurës së nisur dhe të pezulluar të procesit të privatizimit të objektit që kishte me kontratë qiraje. Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 601/7, datë 22.10.2018 ka vënë në dijeni ankuesen për gjetjet e raportit të auditit në lidhje me ribërjen e procedurës së ankandit dhe vlerësimin e objektit me vlerën e mëparshme. Në mes të tjerash KLSH kishte konstatuar se për vitet 2015-2016 dhe në vitin 2017¹ është lidhur:

- Kontratë qiraje pa numër, 100 prot datë 01.03.2017, lidhur mes personit fizik A.SH dhe drejtorit të spitalit K.K për objektin e marrë me qira me sipërfaqe 42m² dhe sipërfaqe funksionale 120 m² me çmim 160 lek/m² objekti dhe 30 lekë/m² sipërfaqja funksionale në total 10.320 lekë në muaj qira.

¹ Sipas gjetjeve të KLSH po detajohet vetëm kontrata e vitit 2017.

- Kontratë qiraje pa numër, 85 prot datë 15.02.2017, lidhur mes personit fizik A.Z dhe drejtorit të spitalit K.K për objektin e marrë me qira me sipërfaqe 37.5 m² me çmim 400 lekë/m² objekti në total 15.500 lekë në muaj qira. Me aktivitet mallra të ndryshëm dhe fruta perime funksionale edhe sot.
- *Për lidhjen e kontratës së qiranë 85 prot. me çmim dukshëm më të lartë se çmimin sipas VKM nr.54, datë 05.02.2014, që për qytetin e Gjirokastrës është 75 lekë/m² dhe më të lartë se objekti tjetër i dhënë me qira duke diskriminuar këtë subjekt dhe ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.*

Ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore për trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me shkresën nr.1617, datë 15.11.2018 dhe e-mail-in datë 15.11.2018, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankueses të paraqesë shpjegime lidhur me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore të trajtimit të pabarabartë me qiramarrësit e tjerë dhe kopje të kontratës së qirasë për vitet 2017 dhe 2018.
- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, S.Z me e-mail-in dhe shkresën datë 19.11.2018 ka dërguar parashtrime dhe kopje të kontratës së qirasë nr.85 datë 15.02.2017. Në parashtrime subjekti ankues në mes të tjerash ka informuar Komisionerin si më poshtë: *“Vetëm nga shkresat e KLSH-s nr. 601/7, datë 22.10.2018 janë vënë në dijeni të diskriminimit të bërë personit fizik A.Z, në marrjen me qira të objektit. Diskriminimin në raport me qiramarrësin e objektit tjetër A.Sh me sipërfaqe më të madhe, për të cilën paguan 160 lekë/m² ndërsa A.Z paguan 400 lekë/m² për një sipërfaqe 37m², ndërkohë që me VKM nr.54, datë 05.02.2014, çmimi duhet 75 lekë/m². Nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, ka sjellje diskriminuese dhe të pafavorshëm të S.Z dhe A.Z dhe ekziston një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (barazia e subjekteve qiramarrës përsa i përket çmimit të qirasë të përcaktuar në VKM) dhe gjendjes në fakt me trajtimin që i është bërë subjektit tjetër A.Sh. Të gjitha këto veprime janë kryer për të favorizuar në privatizim subjekte të tjera të interesuara nëpërmjet presionit të ushtruar ndaj subjektit A.Z. Janë bërë edhe si hakmarrje ndaj rezistencës në mbrojtje të interesit të ligjshëm, qoftë me ankimet administrative të paraqitura dhe të konsideruara të drejta nga organi epror i Spitalit Rajonal Gjirokastrë”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të trajtimit të pabarabartë në zbatimin e ligjit dhe VKM nr.54, datë 05.02.2014, në dhënien me qira të objekteve, nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose*

filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë për shkak të gjinisë, por në lidhje me këtë, Komisioneri bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion nga ankuesja, vlerëson se që nga data 15.09.2004 kontrata e qirasë për marrjen me qira të objektit me sipërfaqe 37.5m² është e regjistruar në emër të A.Z dhe S.Z nuk figuron si qiramarrëse.

Përsa më sipër, mbështetur në nenin 64², paragrafi 1 dhe nenin 65³ paragrafi 1 i Kodit Civil, S.Z, nëse do të jetë përfaqësuese ligjore e A.Z, duhet të legjitimohet të përfaqësojë atë, duke kërkuar në emër të tij pranë Komisionerit, që ky i fundit të hetojë për diskriminim, ndaj Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

Në respektim të parashikimeve të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku në nenin 33, pika 1 citohet: “Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet

² Neni 64, paragrafi I, i Kodit Civil parashikon: “Me përfaqësimin, një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar)”.

³ Neni 65, paragrafi I, i Kodit Civil parashikon: “Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuarit caktohen me prokurë”.

procesverbal”, ankuesja duhet të legjitimohet për përfaqësimin e A.Z pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Përsa më sipër dhe në kushtet kur S.Z nuk legjitimohet për të përfaqësuar A.Z pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në këto kushte, referuar nenit 33, pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku citohet: “Ankesa nuk pranohet nëse, është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa e S.Z, nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të shqyrtimit, pasi nuk plotëson kriteret e parashikuara në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/b dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasës S.Z, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI